



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 56 , datë 29.12.2017

PËR

**MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a:

a. Për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura për zonën ekzistuese si më poshtë :

Kategoria e klientëve	Tarifa volumetrike		Tarifa fikse
	Furnizim me ujë (lekë/m ³)	Largimi i ujërave të ndotura (lekë/m ³)	(lekë/klient/muaj)
Klientë familjar	72	42	140
Klientë publik	117	64	140
Klientë privat	140	64	140

b. Për shërbimin e furnizimit me ujë për zonat e reja:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Njësiti administrative			
			Mollaj, Bulgarec Qënder	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (të tjerat)	Drenovë	Voskopojë
1	Konsumatorë familjar	lek/m ³	38	28	28	28
2	Konsumatorë publik	lek/m ³	110	110	110	110
3	Konsumatorë privat	lek/m ³	100	100	100	100
4	Tarifë fikse	lek/muaj/klient	100	100	100	100

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018 janë si më poshtë:

Treguesit e Performancës	Viti 2018
Mbulimi me ujë	93%
Mbulimi me kanalizime	73%
Niveli i Matjes	91%
Uji pa të ardhura	25%
Norma e arkëtimit	94%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a do të jetë 0.6 % e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 23.12.2013 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha UK Korçë" shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 01.01.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

K R Y E T A R I
Ndriçim SHANI